

PROCESVERBAL-Tipi I kontratës-PUNË
PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky proces verbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROKURIMIT:

“Ndërtimi i sistemit të kanalizimeve të Njesisë administrative Cerave, për fshatrat , Qershize , Cerave . Lumas, Alarup, Leshnice , Bashkia Pogradec.”

“

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT(CPV):

45000000-7 Punime ndërtimi

VLERA E FONDIT LIMIT:

Fondi limit/vlera e pritshme e kontratës: **596 048 006,59 (peseqind e nentedhjet e gjashte milion e dyzet e tete mije e gjashte presje pesedhjet e nente) lekë pa TVSH** (financim sipas planit buxhetor të ardhur në thesar)

Fondi limit në Euro.6 511 339.37 (Vlera në Euro është konvertuar sipas kursit zyrtar (me 91.54 (te Bankes se Shqiperise dt.18.09.2026)

Argumentimi: Fondi limit i procedurës është përcaktuar mbi bazën e preventivit të hartuar nga projektuesi i autorizuar, i cili përmban analizën e detajuar të volumeve të punimeve, çmimeve njësi dhe kostove përkatëse për realizimin e objektit të kontratës. Preventivi është përgatitur në përputhje me projektin e zbatimit dhe specifikimet teknike të miratuara.

Në zbatim të nenit 76 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, dhe rregullave të parashikuara në VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, autoriteti kontraktor ka përllogaritur vlerën e parashikuar të kontratës mbi bazën e një analize reale dhe të dokumentuar të kostos së punimeve. Për këtë arsye, fondi limit është mbështetur në preventivin e projektuesit, i cili përfaqëson vlerësimin teknik dhe ekonomik të nevojshëm për realizimin e plotë të objektit të prokurimit, duke garantuar përdorimin me eficiencë të fondeve publike dhe zhvillimin e një procedure konkurruese.

Preventivi i hartuar nga projektuesi përfshin zërat e punimeve, sasi të, analizat teknike dhe çmimet përkatëse, të cilat janë bazuar në metodologjinë e hartimit të preventivave të punimeve të ndërtimit dhe përbëjnë bazën objektive për përcaktimin e fondit limit të procedurës së prokurimit. Kjo metodë siguron që fondi limit të jetë i argumentuar teknikisht, ekonomikisht dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi

Argumentim I Autoritetit Kontraktor

Autoriteti Kontraktor, në zbatim të nenit 87 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, ka vendosur që oferta fituese të identifikohet sipas metodës **“Oferta e bazuar në kosto”**, duke u mbështetur në raportin më të mirë **cilësi–çmim**, pasi objekti i kontratës **“Ndërtimi i sistemit të kanalizimeve të Njesise administrative Cerave, për fshatrat , Qershize , Cerave . Lumas, Alarup, Leshnice , Bashkia Pogradec.”** është një investim publik kompleks, ku cilësia e realizimit ndikon drejtpërdrejt në funksionalitetin, jetëgjatësinë dhe kostot e operimit të sistemit.

Përzgjedhja vetëm mbi bazën e çmimit më të ulët nuk garanton domosdoshmërisht realizimin e një infrastrukture me standardet e kërkuara teknike dhe funksionale. Në investimet e ujësjellësit, rëndësi të veçantë kanë organizimi i punimeve, mobilizimi në kantier, aftësia organizative e operatorit ekonomik, masat për mbrojtjen e mjedisit dhe garancia e punimeve, pasi këta elementë ndikojnë drejtpërdrejt në cilësinë e veprës dhe në reduktimin e kostove gjatë ciklit të jetës së saj.

Për këtë arsye, Autoriteti Kontraktor ka vlerësuar se është në interes publik të mos mbështetet ekskluzivisht në çmim, por të vlerësojë edhe elementët cilësorë që lidhen drejtpërdrejt me objektin e kontratës, konkretisht:

Grafiku i punimeve dhe koha e mobilizimit (20 pikë), pasi organizimi dhe mobilizimi i shpejtë ndikojnë në respektimin e afateve kontraktore, minimizimin e ndërprerjeve të furnizimit me ujë dhe uljen e kostove indirekte gjatë zbatimit.

Stafi dhe organizimi i kompanisë (15 pikë), pasi një strukturë organizative e mirë garanton menaxhim efektiv të punimeve, koordinim të proceseve dhe kontroll më të mirë të cilësisë.

Masat për uljen e ndikimit në mjedis dhe ndikimit social (10 pikë), duke qenë se punimet e ujësjellësit zhvillohen në zona të banuara dhe shoqërohen me gërmime, ndërhyrje në infrastrukturën ekzistuese dhe ndikime të përkohshme mbi komunitetin. Vlerësimi i këtyre masave është në përputhje me nenin 87 të ligjit, i cili lejon përdorimin e kriterëve mjedisore dhe sociale.

Periudha e garancisë (5 pikë), pasi një garanci më e gjatë rrit sigurinë e Autoritetit Kontraktor për cilësinë e punimeve dhe ul rrezikun e shpenzimeve shtesë pas marrjes në dorëzim të objektit.

Pesha prej **50 pikësh për çmimin** dëshmon se elementi ekonomik mbetet faktori kryesor në vlerësim, ndërsa **50 pikët e mbetura** u kushtohen elementëve teknikë dhe cilësorë që lidhen drejtpërdrejt me realizimin e kontratës. Kjo shpërndarje është proporcionale me natyrën e investimit dhe synon identifikimin e ofertës ekonomikisht më të favorshme, duke garantuar përdorimin me ekonomi, efektivitet dhe eficiencë të fondeve publike.

Autoriteti Kontraktor vlerëson se kjo metodë realizon në mënyrë më të plotë parimet e barazisë, transparencës, proporcionalitetit dhe konkurrencës së ndershme, si dhe siguron zgjedhjen e operatorit ekonomik që ofron jo vetëm çmimin më konkurrues, por edhe garancinë më të mirë për realizimin me cilësi të investimit publik.

Së pari në DST Kapitulli 4.4 “Kriteret e përzgjedhjes së fituesit” Autoriteti Kontraktor gjykoj që të vlerësohet mbi bazën e Ofertës ekonomikisht më të favorshme, bazuar në kosto X

4.4 Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

A) Oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në kosto ¹ x

Sipas rëndësisë:

Çmimi □	pikët 50
Grafiku i punimeve dhe koha e mobilizimit □□	pikët 20
Stafi / Organizimi i Kompanisë □□	pikët 15
Propozimet për uljen e ndikimit në mjedis dhe ndikimin social □□	pikët 10
Periudha e garancisë së objektit □□	pikët 5

Autoriteti/Enti Kontraktor duhet të specifikojë pikët për secilin kriter të përcaktuar të vlerësimit.

Metodologjia e vlerësimit për Ofertën ekonomikisht më të favorshme bazuar në kosto

Kriteret e vlerësimit:

Të gjitha kriteret vendosura për vlerësimin e ofertave duhet të jenë sa më objektive dhe të shprehen në shifra. Në çdo rast kur kriteret janë më shumë se një, pesha e kriterit të çmimit nuk do të jetë më pak se 50 pikë. Pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë 100. Autoriteti kontraktor do të vlerësojë pikët për kriteret me vlerësim relativ (kriteri 1, 2.a, 5) e rrumbullakosur me dy shifra pas presjes dhjetore (0,00) ndërsa për kriteret me vlerësim absolut (kriteri 2.b , 3, 4) do të vlerësohen me numra të plotë (0).
Kriteri:

1. Çmimi [50] pikë

Operatori ekonomik duhet të detajojë dhe përshkruajë ofertën e tij.

Pikët për këtë kriter përlogariten sipas formulës:

$$P_{k1} = V_{\min k1} \times P_{\max k1} / O_{k1}$$

P_{k1}	Pikët e kriterit që vlerësohet
$V_{\min k1}$	Vlera e më e ulët e kriterit që vlerësohet
$P_{\max k1}$	Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet
O_{k1}	Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

2. Grafiku i punimeve dhe koha e mobilizimit [20 pikë]

Operatori ekonomik mund të propozojë duke paraqitur një grafik të detajuar që argumenton kohën e propozuar për përfundimin e punimeve të kontratës. Operatori duhet të argumentojë (në mënyrë përshkimore dhe grafike) kohën e propozuar (**jo më shumë se 20 muaj e 3 javë**). Vlerësimi i pikëve për këtë kriter do të realizohet sipas përshkrimit të mëposhtëm të ndarë sipas nën-kritereve.

Nënkriteri:

- a. Koha e realizimit të punimeve të kontratës që përfshin: [15 pikë]
- I Kohën e mobilizimit në kantier (jo me shume se 30 dite) [2 pike].
- II Grafiku i punimeve te Kontratës. [13 Pike]

*Shënim: Operatori ekonomik për të justifikuar propozimin e këtij nënkriteri duhet të paraqesë minimalisht analizen e makinerive që do angazhojë operatori ekonomik për secilin proces dhe numrin e përafërt të punonjësve të angazhuar për çdo proces.

Pikët për këtë nën-kriter përlogariten sipas formulës:

$$P_{k2a} = V_{\min k2a} \times P_{\max k2a} / O_{k2a}$$

P_{k2a}	Pikët e kriterit që vlerësohet
$V_{\min k2a}$	Vlera e më e ulët e kriterit që vlerësohet
$P_{\max k2a}$	Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

¹Shënim. Të gjitha kriteret e vendosura për vlerësimin e ofertave duhet të jenë sa më objektive dhe të shprehen në shifra. Në çdo rast, kur kriteret janë më shumë se një, pesha e kriterit të çmimit nuk do të jetë më pak se 50 pikë. Pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë 100 pikë.

O_{k2a} Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

- b. Faktorë favorizues / pajisje inovative / metodologji punimesh që favorizojnë kohën e realizimit të punimeve [0-5 pikë]

3. Stafi / Organizimi i kompanisë [15 pikë]

Operatori ekonomik duhet të tregojë se do të angazhojë në kontratë staf me eksperiencë të mjaftueshme për të realizuar me sukses objektin e prokurimit. Për të treguar këtë fakt operatori duhet të depozitojë për secilin nga stafi kryesor dokumentacionin e kërkuar në seksionin 2.3 / Kriteret e veçanta të kualifikimit. Vlerësimi i pikëve për këtë kriter do të realizohet sipas përshkrimit të mëposhtëm të ndarë sipas nën-kritereve.

Nën-kriteri:

- a. Kualifikimi I stafit Kyc dhe eksperiencia në fushën specifike [13 pikë]

*Shënim: Vlerësimi i këtij nënkriteri do të realizohet sipas përcaktimeve më poshte:

I. Dëshmi që stafi disponon diplome universitare [6 pike]

II. Dëshmi që stafi disponon punë të ngjashme me objektin e prokurimit [4 pike]

III. Dëshmi që stafi disponon eksperiencë mbi 1(një) vit punë [2 pike]

IV. Dëshmi që stafi disponon eksperiencë në natyrë/kompleksitet të ngjashme me kontratën e prokurimit. [1 pike]

Për përmbushjen e kritereve të mësipërme duhet të dorëzohet CV dhe dëshmi/reference/dokumentacion të leshuar nga punëdhënësi të mëparshëm ose përfituesit.

- b. Skema e organizimit të stafit e propozuar për realizimin e kontratës objekt prokurimi [0 - 2 pikë]

*Shënim: Për përmbushjen e kriterit të mësipërm operatori ekonomik duhet të dorëzojë organigramën e propozuar të stafit që do të operojë në ekzekutimin e kontratës, metodologjinë të ndërtimit të strukturave me njëra-tjetrën, me mbikëqyrësin e punimeve dhe Autoritetin Kontraktor/Entin. Avantazh përbejnë sistemet e brendshme të kontrollit dhe menaxhimit të cilësive.

4. Propozimet për uljen e ndikimit në mjedis dhe ndikimin social [0-10 pikë]

Operatori ekonomik duhet të paraqesë një metodologji të qartë për minimizimin e ndikimit në mjedis të veprës si dhe propozimet e tij për menaxhimin e riskut mjedisor dhe social (sipas Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis dhe Social (VNMS)). Vlerësimi i pikëve për këtë kriter do të realizohet sipas përshkrimit të mëposhtëm të ndarë sipas nën-kritereve.

Nën-kriteri:

- a. Propozime konkrete për përdorimin e materialeve ekologjike (miqësore me mjedisin) / të ricikluara / efikase / materiale që minimizojnë ndikimin mjedisor. Përdorimi i makinerive / pajisjeve ekologjike. Hartimi i një plani propozimi të menaxhimit dhe kontrollit të minimizimit të efekteve mjedisore. [0-5 pikë]
- b. Propozime konkrete për përmirësime të ekonomisë lokale të zonës ku zhvillohet projekti si një iniciativë sociale e ofruesit nëpërmjet punësimeve. [0-5 pikë]

5. Periudha e garancisë së objektit [0 – 5 pikë]

Vlerësimi i pikëve për këtë kriter do të realizohet sipas përshkrimit të mëposhtëm:

Periudha e garancisë së punimeve civile / pajisjeve (jo më pak se 2 vjet) [0 - 5 pikë]

Pikët për këtë nën-kriter përllogariten sipas formulës:

$$P_{k5} = V_{\min k5} \times P_{\max k5} / O_{k5}$$

P_{k5} Pikët e kriterit që vlerësohet

V_{min k5} Vlera e më të ulët e kriterit që vlerësohet

P_{max k5} Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

O_{k5} Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

Ndarja në Lote:

Po



Jo

X

1. Arsyeja pse nuk eshte ndare ne lote: Autoriteti ka vendosur te zhvilloj proceduren pa lote pasi natyra e kontrates nuk eshte e perzier, por pune ndertimi sipas relacionit teknik, projektit, etj.

Punimet e parashikuara për ndërtimin e sistemit të kanalizimeve në fshatrat Qershizë, Çërravë, Lumas, Alarup dhe Leshnicë janë pjesë e një ndërhyrjeje të integruar infrastrukturore dhe funksionale. Elementët e sistemit, përfshirë rrjetet, kolektorët, pusetat, lidhjet dhe veprat përkatëse, janë të ndërlidhura teknikisht dhe funksionalisht dhe duhet të realizohen në përputhje me projektin e miratuar si një sistem i vetëm.

2. Ndarja në lote do të krijonte ndërfaqe të shumta teknike ndërmjet kontraktorëve. Në rast të kontraktorëve të ndryshëm për zona ose pjesë të ndryshme të sistemit, do të krijoheshin ndërfaqe në pikat e lidhjes së rrjeteve dhe veprave, duke rritur riskun e mospërputhjeve teknike, problemeve me kuotat, diametrat, pjerrësitë, lidhjet hidraulike dhe parametrat e projektit.

3. Është e nevojshme përgjegjësia e unifikuar për funksionimin e sistemit. Duke qenë se objekti synon ndërtimin e një sistemi funksional kanalizimesh, realizimi nga një kontraktor i vetëm mundëson që përgjegjësia për cilësinë, përputhshmërinë teknike, koordinimin dhe funksionimin e të gjithë sistemit të jetë e unifikuar.

4. Ndarja në lote do të vështirësonte koordinimin dhe mbikëqyrjen e punimeve. Punimet do të zhvillohen në territorin e së njëjtës Njësi Administrative dhe lidhen me njëri-tjetrin në aspektin teknik dhe të zbatimit. Përdorimi i disa kontraktorëve do të kërkonte koordinim të vazhdueshëm ndërmjet kontratave, përcaktim të përgjegjësive në zonat e ndërfaqes dhe administrim të disa kontratave të veçanta.

5. Rreziku i vonesave në një pjesë të sistemit mund të ndikojë në funksionimin e pjesëve të tjera. Për shkak të karakterit të integruar të infrastrukturës së kanalizimeve, përfundimi i një pjese të punimeve nuk garanton funksionalitetin e saj të plotë nëse pjesët e tjera të sistemit nuk janë realizuar ose lidhur në kohë.

6. Përfundimi dhe marrja në dorëzim kërkojnë një vlerësim të integruar. Testimi, kolaudimi dhe vënia në funksion e sistemit kërkojnë që komponentët e tij të jenë të realizuar dhe të lidhur në përputhje me projektin. Një kontratë e vetme lehtëson procesin e testimit, marrjes në dorëzim dhe përcaktimit të përgjegjësisë kontraktore.

7. Ndarja në lote nuk sjell një ndarje të natyrshme të objektit sipas funksionit. Ndarja thjesht sipas fshatrave ose segmenteve gjeografike nuk do të përputhej domosdoshmërisht me ndarjen teknike të sistemit, pasi rrjetet dhe veprat e kanalizimeve funksionojnë si pjesë të një sistemi të ndërlidhur.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,
- Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

Referuar pikës 1 të shtojcës 7, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 8.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 26 të VKM-se nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Kopje të deklaramit të xhiros vjetore gjatë 3 (tre) viteve të fundit financiare (2023, 2024, 2025) lëshuar nga Autoriteti përkatës, ku vlera e xhiros minimale vjetore nuk mund të kalojë dyfishin e vleres së perlllogaritur se kontrates .

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor

2.2.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë kopje të çertifikuara të bilanceve të 3 (tre) viteve të fundit financiare (2023, 2024, 2025) (Bilancet të parqiten konform parashikimit të nenit 41 shkronja c) të Ligjit nr. 1009/2009). *(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse në dy balance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit).*

Shënim: Akt Ekspertiza e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, duhet të paraqitet nga OE vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41 e Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në Nenin 77, pika 1/b dhe 3 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik ku përcaktohet se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në :b) **gjendjen ekonomike dhe financiare ;...** 3)Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë **një xhiro vjetore minimale të caktuar**. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin **informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit**. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës...”

Në **nenin 43**“Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare” të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021“Përmiratimin e rregullave të Prokurimit Publik” ku parashikohet: “Autoritetit kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, **kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3(tre) vitet e fundit financiare.**”

Ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar nuk mund të kalojë dyfishin e vleres së perlllogaritur se kontrates .

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor

...a) dyfishin e perlllogaritur të kontrates ose lotit në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar;

Nëse vlerësohet, Autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vite te fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Gjithashtu, për caktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke i'u referuar legjislacionit të fushës, konkretisht:

Ligji nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, neni 29 i tij i cili përcakton “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar nëudhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancinkontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5 datë 30.01.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat ”, i ndryshuar pika 3.12 etij, dhe kërkesave të **Ligjit Nr.25 datë 10.05.2018** “Për Kontabilitetin dhe pasqyrat financiare ” neni 9 i tij ku parashikohet: “Kohëzgjatja e periudhës raportuese është 12 muaj. Periudha raportuese fillon në datën 1 janar dhe përfundon në datën 31 dhjetor. Përfundimet për veprimtaritë e veçanta, me propozimin e Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit , miratohen nga ministri përgjegjës për financat”.

Ligji Nr.10091 datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar” (i ndryshuar) neni 41 i tij, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.922, datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike” gjykojmë që të kërkojmë xhiron vjetore dhe pasqyrat financiare për tre vitet e fundit (2021,2022,2023) pasi tatimpaguesit (operatorët ekonomikë) kanë detyrimin të dorëzojnë në administratën tatimore brenda **datës 31 mars të vitit pasardhës** bilancin kontabël së bashku me anekset e tij si dhe Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar në rastet kur plotësohen kushtet e parashikuara nga ligji.

Komisioni përcaktoi kriteret për kapacitetet ekonomike dhe financiare si më lart, duke qenë se këto kriteret janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, dhe i shërbejnë Autoritetit Kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:

Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale përsa i përket aftësisë teknike e profesionale

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme

a) punë të ngjashme **për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 238 419 202.63(dyqind e tridhjet e tete milion e katerqind e nentembdhjete mije e dyqind e dy pike gjashtedhjet e tre) 40% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit**, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose

b) punë të ngjashme deri në një kufi, **ku vlera monetare totale e punëve të kryera**, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit është **jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet**.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpermendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Pika 2.3.1/a plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cili prej tyre do të përmbushë këtë kusht. Kurse pika 2.3.1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

2.3.1/1 Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentet e mëposhtme:

- a) Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
 - Formular Vlerësimi për realizimin e punimeve sipas Shtojcës nr. 9, shoqëruar me:
 - Kontratë Sipërmarrje
 - Situacionin përfundimtar;
 - Faturat tatimore,
 - Aktin e kolaudimit;

Shënim: *Formulari i vlerësimit duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve dhe faktin nëse kontrata është realizuar me sukses.*

- b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Vërtetim lëshuar nga subjekti privat shoqëruar me:
- Kontratë Sipërmarrje;
- Situacionin përfundimtar;
- Faturat tatimore të deklaruara në organet tatimore;
- Akt kolaudimi objekti;

Shënim: *Vërtetimi duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve dhe faktin nëse kontrata është realizuar me sukses*

2.3.1/2 Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën e bashkimit të operatorëve dhe prokurën e posaçme të deklaruara në fazën e tenderimit;

2.3.1/3 Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën bazë ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor, si dhe Miratimin zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.

Argumentimi:Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77 pika 4 të Ligjit Nr.162/2020“Për Prokurimin Publik”ku përcaktohet se:“Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale,autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burime te nevojshme njerëzore e teknike,si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. **Autoritetet ose entet kontraktore,në veçanti,mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një.Nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.”**

Në nenin 39“Kërkesat të veçanta për kontratat për punë publike”pika 5 dhe 8 te VKM Nr. 285datë 19.05.2021“Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”,të ndryshuar ku përcaktohet se:“Për të provuar përvojën e mëparshme,autoriteti/enti kontraktor kërkon:**a)punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 40% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit,nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;b)punë të ngjashme deri në një kufi,ku vlera monetare totale e punëve të kryera,e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit,është jo më e madhe se dyfishi I vlerës limit të kontratës që prokurohet.** Plotësimi I njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme. Autoriteti/entikontraktor,si dëshmi për përvojën e mëparshme,kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik,për përmbushjen me sukses të kontratës,ku të shënohen vlera,afati I përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti /enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime,për përmbushjen me sukses të kontratës,ku të shënohen vlera,afati I përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë,e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi ,që provon realizimin me sukses të punëve. Autoriteti/enti kontraktor,përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat I vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.”

Autoriteti Kontraktor përcaktoi kriteret për punë të ngjashme si më lart duke qenë se këto kritere janë të detyrueshme,janë në përpjesëtim dhe të lidhura me objektin e kontratës.**Përvoja te mëparshme** janë element shumë i nevojshëm,që garantojnë autoritetin se operatorët ekonomikë zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën mesukses sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.Kriterii kapacitetit teknik siguron se operatorët ekonomikë që marrin pjesë në procedure kanë përvojën dhe ekspertizën e nevojshme për të kryer punën me cilësi të lartë.Pjesëmarrja e operatorëve ekonomikë mëpërvojë të mëparshme siguron që puna do të kryhet me sukses dhe pa ndërprerje.Përvojat e mëparshme në projekte të ngjashme siguron që operatorët të jenë të gatshëm për situata të papritura dhe janë në gjendje të menaxhojnë situata te mundshme në mënyrën e duhur.Kriteri i kapacitetit teknik ndihmon në sigurimin e njëkonkurrence të ndershme dhe të përshtatshme në procedurë.

Referuar këtij neni,AK vlerëson se duhen kërkuar disa prej dokumentave ligjore të zbatimit të punimeve,bazuar në Ligjin Nr.8402datë10.09.1998“Për kontrollin dhe disiplinimin e ndërtimit”(I ndryshuar),si dhe akteve dhe VKM të dala në zbatim të tij, pasi duke qenë se kontrata për punë publike që prokurohet është në bazë të punimeve me matje,sipas nenit 39pika1/a e VKM-së,lind e nevojshme që operatorët ekonomikë pjesëmarrës krahas dokumentacioni t të përcaktuar në nenin 39pika 5/a dhe b,të paraqesin edhe situacionet përfundimtare dhe formular vleresimi për punët e kryera me entet publike.Kjo bëhet me qëllim që autoriteti kontraktor të bindet nëse operatori ekonomik zotëron përvojën e nevojshme për zbatimin e kontratës,ku punime te mëparshme duhet të kenë zëra të konsiderueshme punimesh me zëra

te punimeve që po prokurohen, si dhe në rastin kur punime te mëparshme janë kryer si bashkim operatorësh ekonomikë,nuk jepet informacion mbi përqindjen e anëtarëve në bashkim,në vërtetimet që lëshojnë autoritetet kontraktore dhe në faturat tatimore të shitjes, ku këto tëfundit lëshohen nga përfaqësuesi i bashkimit të operatorëve ekonomikë. Meqënëse paraqitja e dokumentacionit të mësipërm,nuk sjell diskriminim dhe/ose kosto shtesë për operatorët ekonomikë pjesëmarrës,por i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e përvojës së duhur të tyre,duke mundësuar zhvillimin normal dhe në kohë të procedurës së prokurimit,pasi nuk ka nevojë që Autoriteti të kërkojë informacione shtesë gjatë vlerësimit të ofertave (në rast mungese të informacionit të sipërcituar),A K gjykon se kërkimi i dokumentacionit të përcaktuar në kushtin e mësipërm është I nevojshëm për vërtetimin e kryerjes së punëve të ngjashme.

Ndërsa me ndryshime te reja ligjore përkatësishtme VKM Nr. 498,datë01.8.2024për disa shtesa dhe ndryshime në VKM Nr285 datë19.05.2021, Neni 16 ku parashikohet“Në paragrafin e fundit, të pikes 5, të nenit 39,“Kërkesatë veçanta për kontratat për punë publike”,pasfjalëve“...,e shoqëruar me fatura tatimore...”shtohen“...**të deklaruara në organet tatimore...**”u kërkua që në kërkesën e bërë për punime te ngjashme të kryera dhe të realizuara me sektorin privat:si dëshmi përpërvijën e mëparshme të realizuar me sektorin privat,tëparaqiten vërtetime të shoqeruara me faturat tatimore të shitjes,të deklaruara në organet tatimore ku të shënohen datat,shumat, natyra e punës së kryer dhe situacion përfundimtar për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.

2.3.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, sipas formatit të miratuar me *VKM Nr. 42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”*. Shqyrtimi i licencave do të bëhet mbi bazën e rregullave të parashikuara sa më sipër. Licenca profesionale e operatorit ekonomik lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës duhet të përmbajë:

Kategoritë e mëposhtme:

Shoqëritë e huaja duhet të bëjnë ekuivalentimin e licencave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM-në Nr. 42, datë 16.01.2008).

Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues.

Nr.	Licensa	Kategoria e kryerjes së punimeve
1	NP-1-C	Punime gërmimi në tokë
2	NP-4-B	Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvaj, metro, pista aeroportuale
3	NP-5-B	Punime nëntokësore, ura, vepra arti
5	NP-7-E	Ujesjellesa, gazsjellesa,vajsjellesa, vepra kullimi e vaditje
6	NP-9-A	Punime dhe mbrojtje lumore sisteme hidraulike dhe bonifikime
7	NP-12-E	Punime inxhinierike mjedisore
8	NS-1-C	Punime per prishjen e ndertimeve
10	NS-20-A	Shpime gjeologo-inxhinierike, puse e shpime per uje
11	NS-21-A	Impliante te trajtimit te ujerave te zeza

<i>Kategoria e kerkuar</i>	<i>Pershkrimi i kategorise sipas legjislacionit te fushes</i>	<i>Zerat e punimeve qe parashikohen te kryhen ne preventiv qe perfshihen ne kategorine perkatese</i>	<i>Niveli i klasifikimit te kerkuar per kategorine respektive</i>	<i>Vlera e punimeve qe parashikohen te kryhen ne preventiv, qe perfshihen ne kategorine perkatese</i>
NP- 1 C	Punime gërmimi në tokë	1.Punime Germimi 2.Punime Dheu	51-100 milion leke	93,527,584.79
NP-4B	Rruge autostrada,ura, mbikalime ,hekuridha ,linja tramvaji,metro,hekur udhe me kavo dhe pista aeroportuale	3.Punime shtresash	21-50 milion	25,580,491.67
NP-5B	Punime nentokesore,ura e vepra arti	3.Ndertime vepora arti punime galeri natyrore	21-50 milion	21,138,939.07
NP-7-E	Ujësjiellës, gazsjellës, vajsjiellës, vepra kullimi e vaditje”	14.Instalime Hidro-Sanitare dhe ngrohje 15.Gaz e Naftesjielles 20.Ujesjielles e Kanalizim i jashtem 21.Analiza jashte liste	201-400 milion	325,343,494.33
NP-9 A	Punime mbrojtje lumore,sistemime hidraulike dhe bonifikime	Nderhyrje ne rrjet	0-20 milion	13,947,982.2
NP-12E	Punime inxhinierike mjedisore	Konsiderohen ndertime mirembajtje dhe rsitrukturime dhe punime te vecanta per vete specifiken e projektit ka ndikim te drejperdrejte ne mjedis ne te gjitha kategorite e punimeve qe do te kryhen ka prishje dhe rikthim ne gjendjen fillestare te te gjitha siperfaqeve mjedisore qe do te preken nga ky ndertim si dhe duke mare parasysh sasine e madhe te mbetjeve te gjeneruara nga punimet e	201-400 milion	325,343,494.33

		prishjeve, germimet e dheut etj.		
NS-1-C	Punim per prishjen e ndertimeve	9.Prishje	51-100 milion leke	85,047,429.6
NS-20-A	Shpime gjeologjike – inxhinierike, pus de ,shpimi per uje	Perfshin shpim mikrotuneli per ndertimin e objektit inxhinierik	0-20 milion	3,227,930.82
NS-21-A	Impiante te trajtimit te ujerave te zeza	Punime te kompletuara me cdo punim te lidhur me muraturen plotesuese ose ndeihmese te vecanta ose ne rrjet	0-20 milion	2,850,498.8

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Nenin 77, pika 1 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar; Neni 39, pika 6/a, e VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, si dhe mbështetur në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”. Referuar kategorive të kërkuara, AK argumenton teknikisht se kjo kërkesë është vendosur sipas zërave të preventivit të punimeve.

Për sa më lart, me qëllim realizimin e punës objekt prokurimi, është kërkuar që Ofertuesit të jenë të pajisur me Licencë profesionale për kategoritë, të cilat janë vendosur sipas volumeve të punimeve dhe vlerave që përmban Preventivi për cdo zë pune mbështetur në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, ku janë përcaktuar kategoritë dhe nënkategoritë përkatëse. Kjo kërkesë është vendosur nga Autoriteti Kontraktor me qëllim shqyrtimin e kualifikimit profesional të Ofertuesve në kuadër të veprimtarisë tregtare objekt prokurimi.

2.3.3 Operatori Ekonomik për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt, duhet të ketë të pënësuar, minimalisht:

- **1 (nje) Inxhinier Ndërtimi;**
- **1 (një) Inxhinier Hidroteknik**
- **1 (një) Inxhinier Mekanik**
- **2 (dy) Inxhinier Topograf**
- **1 (nje) Inxhinier Elektrik**
- **1 (një) Inxhinier Mjedisi me VNM**

****Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës nr. 8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”.*

Për secilin pjesëtar të stafit teknik të mësipërm duhet të paraqesë: Kontratë pune e vlefshme, Diplomë, Librezë pune dhe CV, te rezultojnë te siguroar ne listepagesa për periudhën (muajin e fundit nga data e hapjes se ofertave

Inxhinieri Mekanik mund te disponohet edhe me kontrate bashkepunimi . Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” te ndryshuar dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave tëProkurimit Publik”te dryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinieret në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Numri i stafit kryesor teknik është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

Në kërkesat për personelin e kualifikuar janë kërkuar inxhinierë të licensuar, sipas profileve të domosdoshme për të mbuluar të gjitha punimet e parashikuara në projekt – zbatimin e parashikuar të relizohet nëpërmjet kësaj kontrate. Numri i kërkuar i inxhinierëve është plotësisht ne përpjesëtim me objektin e kontratës duke marrene konsiderate faktin se projekti është i shtrire ne disa fshatra.

-Projekti, objekt i kësaj kontrate parashikon një sasi dhe tipologji të madhe të punimeve të përgjithshme ndërtimore, të tilla si punimet e prishjes, punimet e gërmimit, punimet e shtresave. Zbatimi i punimeve të përgjithshme ndërtimore dhe zbatimi i punimeve strukturore duhet të realizohet me materialet dhe teknologjitë e parashikuara në projektin e zbatimit, metodologjia e ndjekur e zbatimit të këtyre punimeve duhet të përputhet me specifikimet teknike dhe standardet dhe kriteret e zbatimit nga ekspert inxhinier ndërtimi me profil strukturist, ku perfshihen , punime rruge, sinjalistika , punime germimi ne toke , kanalizime , punime hekuri.

-Mbeshtetur ne tipologjine dhe objektin e kontrates , preventivin e punimeve,zbatimi i punimeve të përgjithshme ndërtimore dhe zbatimi i punimeve strukturore duhet të realizohet me materialet dhe teknologjitë e parashikuara në projektin e zbatimit, metodologjia e ndjekur e zbatimit të këtyre punimeve duhet të përputhet me specifikimet teknike dhe standardet dhe kriteret e zbatimit nga ekspert inxhinier ndërtimi me profil transport perfshihen transporti i materialeve te ndertimit , dheut,

-Inxhinier ndertimi , Mbeshtetur ne tipologjine dhe objektin e kontrates , preventivin e punimeve,zbatimi i punimeve të përgjithshme ndërtimore dhe zbatimi i punimeve strukturore duhet të realizohet me materialet dhe teknologjitë e parashikuara në projektin e zbatimit, metodologjia e ndjekur e zbatimit të këtyre punimeve duhet të përputhet me specifikimet teknike dhe standardet dhe kriteret e zbatimit, ne preventiv dhe nga analizat e paraqitura eshte parashikuar struktura mbajtese (palankola) ne analizat jashte liste.

-Inxhinier Hidroteknik, eshte percaktuar ne mbeshtetje te tipologjise, natyres se ndertimeve qe do te kryhen , preventivin e punimve si dhe ne analizat jashte liste te percaktuara nga projektuesi ne te cilin

është percaktuar vendosje , pusëtash tubosh , vete natyra e ndertimit e ka te nevojshem nje inxhinier hidroteknik

-Inxhinier Mekanik , është percaktuar gjithashtu, mbeshtetur ne tipologjine dhe natyren e punimeve qe do te kryhen kryesisht tek preventivi stacion i pompave Lin.

-Inxhinier Topograf do te percaktoje nisur nga tipologjia e punimeve regjistrimin e relievit, identifikon format specifike te tokes. Gjithashtu per shkak te shtrirjes se madhe gjeografike është percaktuar nr i inxhinierëve topografe.

-Inxhinier Elektrik. Punimet elektrike përfshijnë zëra me vlera të konsiderueshme në prevetivin total të punimeve Zërat e përfshirë në preventiv shoqërohen me zgjidhet teknike të hartuara nga eksperti

inxhinier elektrik në projekt, në relacionin teknik dhe specifikimet teknike. Te tilla punime janë instalimi i te gjithë linjave elektrike per stacionin e pompimit, si dhe ne zerat ne preventiv , te ndryshme dhe elektrike. Për këtë arsye, lind nevoja që për zbatimin e punimeve në të gjitha vëllimet e objektit të angazhohen minimalisht nje inxhinier elektrik

-Inxhinier Mjedisi. Punimet për riaftësimin e territorit, si rezultat i dëmeve në mjedis që do të shkaktohen si rezultat i punimeve ndërtimore për zhvillimin e territorit nëpërmjet ndërtimeve të reja duhet të drejtohen nga të paktën një inxhinier i licensuar në fushën përkatëse, inxhinier mjedisi.

2.3.4 Operatori ekonomik pjesëmarrës për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë fuqi punëtore minimalisht 180(njeqinde tetedhjetë) persona. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve për periudhën **muajin e fundit nga data e hapjes se ofertave**, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës nr. 8.

“Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”.

Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin, si më poshtë:

-Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet Shoqërore ose Administrata Tatimore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, ku të specifikohet numri i punonjësve per muajin e fundit nga data e hapjes se ofertave
-Listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën muajin e fundit nga data e hapjes se ofertave

Argumentimi: Autoriteti Kontraktor këtë kriter e ka bazuar në nenin 77, pika 4 të Ligjit nr.162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” në të cilin thuhet: “Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës”.

Numri i punonjësve është percaktuar bazuar në afatin, orët e punës dhe pagën minimale të lejuar, që duhen për të përmbushur zbatimin e kontratës. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë çdo dëshmi me këtë kohë është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve dhe përvojën e tyre, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përveç

besueshmërisë së operatorëve ekonomikë, përpiqet të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës, po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve. Vendorsja e kriterit për një punësim mesatarisht të paktën **180 (njqinde tetedhjetë) punonjes**, duke përfshirë dhe stafin teknik, është në përputhje me volumin e punës, natyrën dhe terrenin ku do të kryhen punimet. Po t'i referohemi projektit, preventivit, relacionit, matjeve përkatëse që ka bërë projektuesi është plotësisht i justifikuar numri i punonjësve. Kriteri për kualifikim është vendosur që t'i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Numri i punonjësve është përcaktuar në baze të grafikut të detajuar për zbatimin e punimeve sipas proceseve të punës, i përgatitur nga ana e projektuesit, ku për një periudhë të caktuar të zbatimit të punimeve numri i punonjësve duhet të jetë mesatarisht të paktën **180 (njqinde tetedhjetë) punonjes**. Në përcaktimin e numrit të punonjësve specialisti i fushës ka bërë një analizë bazuar tek faktorët, si volumet dhe kategoritë e punimeve, kualifikimi i punonjësve, grafiku i punimeve, zërat e punimeve dhe orët e punës dhe pagën minimale të lejuar që duhen për të përmbushur kontratën. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështirje tre mujore nga data e zhvillimit të tenderit, tregon besueshmëri për autoritetin që, operatori do të përmbushë kontratën. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë vërtetimi i lëshuar nga administrata tatimore e shoqëruara me listpagesat me këtë kohështirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve, përvojën e tyre, dhe janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës.

Punësimi i një numri të caktuar, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përpiqet të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës. Po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve. Vendorsja e kriterit për një punësim mesatarisht të paktën **180 (njqinde tetedhjetë) punonjes** duke përfshirë dhe stafin teknik, është në përputhje me volumin e punës, natyrën dhe terrenin ku do të kryhen punimet. Kriteri për kualifikim është vendosur që t'i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Analizat teknike janë bazuar në VKM nr. 629, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre” (Ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018). Bazuar në katër elementet e strukture së kostos (material, puntori, makineri, transport).

(Numri i punonjësve, i mjeteve/makinerive që nevojiten për realizimin e kontratës është përcaktuar bazuar në ligjin Nr. 8402 datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, I ndryshuar dhe akteve nënligjore.

Nga llogaritja e orëve të punës për të gjithë zërat e punimeve të preventivit sipas manualit të çmimeve për fuqinë punëtore konkludojmë si mëposhtëm:

Total Dite pune punëtori = 456 dite pune

Dite pune gjithsej = 20 muaj e tre jave (sipas grafikut të punimeve) * 22 dite/muaj = 456 dite pune,

Numri i fuqisë punëtore = 656 640 orë pune / (456 x 8 orë/ dite) = 180 punëtorë/dite

Në mënyrë të përmblodhur numri i fuqisë punëtore që kërkohej për realizimin e punimeve është minimumi 180 (njqind e tete dhjetë) punonjes

2.3.5 Kandidati ofertues duhet të përcaktoje me anë të një **deklaratë** (nga Administratori i shoqërisë) **Drejtuesin Teknik të punimeve** në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklaroje se do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt.

Argumentimi: Së pari, kjo kërkesë mbështetet në Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

Së dyti, duke qenë se objekt prokurimi është kontratë pune sqarojmë se detyrimin për prezencën e Drejtuesit Teknik gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt e përcakton qartazi

Vendimin nr. 448, datë 31.07.2025 “Për miratimin e rregullores së zbatimit të punimeve të ndërtimit dhe të rregullave të kantierit” ku përcaktohet se: “1. Detyra e drejtuesit teknik të zbatuesit të punimeve është e papajtueshme me çdo punëmarje tjetër, publike a private, jashtë subjektit sipërmarrës. 2. Drejtimi teknik i punimeve në kantier sigurohet, sipas rastit, drejtpërdrejt nga drejtuesi teknik i zbatuesit ose përgjegjësi teknik i kantierit. Për vepra me vlerë të plotë, të preventivuar mbi 30 000 000 (tridhjetë milionë) lekë, përgjegjësi teknik i kantierit është rezident, me kohë pune të plotë në objekt dhe i diplomuar në inxhinieri ndërtimi”.

Lidhur me kërkesën që Drejtuesi Teknik i punimeve në objekt duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të mos jetë i angazhuar në kontrata të tjera, mbështetet në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, KREU IV pika 2, germa b) ku përcaktohet: Drejtuesi teknik i shoqërisë nuk mund të jetë njëkohësisht i punësuar në dy apo më shumë shoqëri ndërtimi si drejtues teknik dhe ndalohet të disponojë licencë për mbikëqyrje e kolaudim të punimeve të zbatimit; dhe KREU III, pika 3, germa “c” ku përcaktohet se: “Ndalohet ushtrimi i veprimtarisë zbatuese në ndërtim në mungesë të drejtuesit/ve teknikë të shoqërisë. Shoqëritë e licencuara jo më vonë se 10 ditë kalendarike, kur drejtuesi teknik është dorëhequr ose ka pamundësi fizike për ushtrimin e detyrës (aksident, sëmundje me paaftësi ushtrimi detyre mbi 14 ditë, invaliditet, ndarje nga jeta), kanë detyrimin të paraqesin njoftim së bashku me kërkesën për drejtuesin e ri teknik të shoqërisë”.

Për sa më lart, çdo kërkesë e renditur për Drejtuesin Teknik, buron nga kontrata e punës objekt prokurimi, me qëllim përmbushjen dhe realizimin e saj sipas kushteve dhe dipsozitive ligjore në fuqi.

2.3.6 Operatori ekonomik ofertues duhet disponojë punonjës të specializuar / kualifikuar si më poshtë:

- a) 1 (nje) punonjës me çertifikatë "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë" në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M Nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier". **si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për të paktën muajin e fundit nga data e hapjes se tenderit, ose nepermjet kontraktimit)**
- b) 1 (një) specialist Ekspert Zjarrfikës ne fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin, në mbështetje të pikës 4 te nenit 49 te Ligjit Nr.152/2015 "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin", te pajisur me çertifikatë të lëshuar nga Drejtoria e MZSH. **(edhe nepermjet kontraktimit)**
- c) - Operatori Ekonomik duhet te kete te punesuar mjekun e shoqerise ose mjek te kontraktuar nga jashte me kontrate sherbimi / me subjekte te specializuara per kete qellim. Mjeket te jene te pajisur me licencë profesionale nga Ministria e Shëndetësisë.

*** Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, ky kusht plotësohet nga i gjithë bashkimi ne perputhje me perqindjen dhe /ose natyren e pjesemarrjes ne pune, te percaktuar me aktmarreveshje.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës perkatese të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Për përmbushjen e këtij kriteri operatori duhet të paraqesë: Diplomë/Certifikatat e cituara më sipër. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.

AK argumenton se kërkesa për Përgjegjësin për sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit në punë është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4; të VKM-së nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Neni 39, pika 6, gërma “c”, si dhe në mbështetje të Nenit 7 të Ligjit Nr. 10237, datë 18.02.2010, “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, i ndryshuar sipas të cilit: “1. Punëdhënësi ngarkon një ose disa punëmarrës, që të merren me çështjet e mbrojtjes, të sigurisë e shëndetit në punë dhe të parandalimit të rreziqeve profesionale në ndërmarrje/institucion”.

Theksojmë se, Autoriteti Kontraktor ka qëllim realizimin e kontratës objekt prokurimi sipas kushteve të përcaktuara në DST, duke respektuar çdo rregull lidhur me kantierin e ndërtimit si dhe me sigurinë e punonjësve gjatë ushtrimit të veprimtarisë së punës. Është e rëndësishme që punimet të realizohen brenda një kantieri të sigurt duke mbrojtur jetën e punonjësve, por dhe të kalimtarëve që mund të jenë përreth vendit të punimeve. Për sa më lart, punonjësi i cili është i çertifikuar si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit në punë", nëpërmjet dijes dhe eksperiencës të fituar në këtë fushë, duhet të shmangë apo parandalojë çdo rrezik që mund të shfaqet gjatë veprimtarisë së shoqërisë dhe që mund të çenojë shëndetin apo sigurinë në punë. Në këto kushte, vendosja e këtij kriteri shërben si një garanci që Ofertuesit do të realizojnë punimet sipas standarteve ligjore në fuqi. AK argumenton se kërkesa për Ekspert Zjarrfikës në fushën e mbrojtjes nga Zjarri dhe për shpëtim është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4; të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”, si dhe në mbështetje të Nenit 49, pika 4 të Ligjit Nr. 152/2015, “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin”, ku citohet se : ”Drejtoria e Përgjithshme e MZSH-së jep certifikatë për personat fizikë e juridikë për ushtrimin e aktivitetit të ekspertit zjarrfikës privat, në bazë të kriterëve të veçanta të miratuara me udhëzim të ministrit”.

Theksojmë se, për shkak të natyrës së punimeve që kryhen: punime elektrike, saldimi etj të cilat kanë potencial të shkaktimeve të aksidenteve me rrezik zjarri kërkohej një specialist për të bërë planin e masave dhe evakuimin në raste aksidentesh ndaj zjarrit prandaj shihet e nevojshme dhe e domozdoshme prania e **1 (një) specialist Ekspert Zjarrfikës në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin**. Ky argumentim është në përputhje me **nenin 77 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”**, sipas të cilit kriteret e kualifikimit duhet të jenë të lidhura dhe proporcionale me objektin e kontratës, si dhe me kërkesat për sigurinë dhe cilësinë e zbatimit të punimeve.

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e nevojshme teknike për realizimin e kontratës. *Per kete duhet te paraqese deshmi per mjetet dhe pajisjet teknike qe ka ne dispozicion apo mund t'i vihen ne dispozicion operatorit ekonomik.*

Nr	Mjetet	Sasia	Gjendja	
1	Kamion vetëshkarkues kapaciteti mbajtës 18 – 20 ton	3 Cope	Pronësi ose me qera	97425 m3 germim 35245 m3 transport
2	Kamion vetëshkarkues kapaciteti mbajtës minimum 20 ton	3 cope	Pronësi ose me qera	97425 m3 germim 35245 m3 transport
3	Eskavator me zinxhir me kove 0.3 m ³	2 Cope	Pronësi ose me qera	97425 m3 germim
4	Eskavator me krah të gjatë min 12m	1 Cope	Pronësi ose me qera	Germim shkambi

5	Kamionçine me kapaciteti mbajtës 2-4 ton	4cope	Pronësi ose me qera	25690 m3 dhe tuba me diameter te ndryshem si edhe F.V puseta
6	Fadrome me goma me kove para dhe mbrapa	2 copë	Pronësi ose me qera	Mbushej dhe ngjeshje dheu
7	Eskavator me goma me kove 0.25 m ³	1 Cope	Pronësi ose me qera	Germim dheu
8	Autovinc me kapacitet min 10 Ton	2 Cope	Pronësi ose me qera	Mrojtja e kanalit me palankola
9	Rrul hekuri per ngjeshje deri ne 2 Ton	1 cope	Pronësi ose me qera	
10	Autofshese per asfaltin	1 Cope	Pronësi ose me qera	
11	Prerese Asfalti	2 cope	Pronësi ose me qera	Prishje te shtresave betoni
12	Asfaltoshtuese	1 Cope	Pronësi ose me qera	
13	Autobitumatrice	1 Cope	Pronësi ose me qera	
14	Rrul Vibrues Gome – Hekur (me kapacitet 9 – 12Ton)	1 Cope	Pronësi ose me qera	
15	Paisje per ngjitjen e Tubave HDPE-613mm	2 Cope	Pronësi ose me qera	Sasi e madhe tubash per ngjitje
16	Paisje per testimin e linjese se tubave me presion	1 Cope	Pronësi ose me qera	

Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas Shtojcës nr. 8.

“Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin, si më poshtë:

1. Për mjetet në pronësi duhet të paraqitet: a) dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (akti i pronësisë); b) leje qarkullimi; c) certifikate e kontrollit teknik; d) siguracion mjeti, (i vlefshëm); e) certifikatë për transport mallrash brenda vendit (e vlefshme).
2. Për mjetet e deklaruar me qera duhet të paraqitet: a) kontrata përkatëse noteriale e qerasë e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi b) dokumenti që verteton regjistrimin e tij (akti i pronësisë) c) leje qarkullimi; ç) certifikaten e kontrollit teknik (e vlefshme) d) siguracion mjeti (i vlefshëm); e) certifikatë për transport mallrash brenda vendit për te trete dhe me qera (e vlefshme).
3. Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes apo çdoganimit, fotot dhe fatura tatimore perkatese, ndersa për mjete të marra me qera krahas dokumentacionit të mesiperm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qerave e cila duhet të përfshijë objektin perkates dhe duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën deri në përfundimin e plotë të punimeve.
4. Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë me shkrim për disponueshmërinë e mjeteve gjatë gjithë periudhës së kontratës.
5. Operatori ekonomik duhet **të paraqesë deklaratë ku Autoriteti** Kontraktor rezervon të drejtën të kryejë në çdo kohë verifikimin fizik të disponueshmërisë së mjeteve, me apo pa lajmërim paraprak, si dhe të bejë deklarinimin e adresës së saktë të vendodhjes së mjeteve me qëllim verifikimin e tyre”

Argumentimi: Kërkesa që operatori ekonomik të paraqesë një deklaratë me shkrim për disponueshmërinë e mjeteve gjatë gjithë periudhës së kontratës është vendosur me qëllim garantimin e **kapacitetit real dhe të vazhdueshëm të operatorit ekonomik për realizimin e objektit të prokurimit.**

Mjetet e kërkuara nuk konsiderohen thjesht si një kriter formal në momentin e ofertimit, por si **burime të nevojshme për realizimin e punimeve/shërbimeve gjatë gjithë periudhës së zbatimit të kontratës**. Për këtë arsye, AK duhet të sigurohet se operatori ekonomik, në rast shpalljeje fitues, do t'i ketë ato në dispozicion dhe nuk do t'i angazhojë në mënyrë të tillë që të cenojë realizimin në kohë dhe me cilësinë e kërkuar të kontratës.

Kjo kërkesë lidhet drejtpërdrejt me **nevojën e AK për të garantuar realizimin efektiv të kontratës** dhe nuk synon kufizimin e konkurrencës, pasi operatori ekonomik mund t'i disponojë mjetet nëpërmjet pronësisë, qirasë ose formave të tjera të ligjshme të disponimit, sipas kërkesave të përcaktuara në dokumentet e tenderit.

E drejta e AK për verifikimin fizik të mjeteve

Argumentimi:

Kërkesa që AK të rezervojë të drejtën për të kryer, **në çdo kohë dhe pa lajmërim paraprak**, verifikimin fizik të disponueshmërisë së mjeteve, si dhe detyrimin e operatorit ekonomik për të deklaruar adresën e saktë të vendndodhjes së tyre, është përcaktuar me qëllim **verifikimin e vërtetësisë së deklarimeve të paraqitura nga operatori ekonomik dhe kontrollin e përmbushjes së detyrimeve të tij gjatë zbatimit të kontratës**.

Verifikimi fizik është i nevojshëm për të garantuar që mjetet e deklaruara **ekzistojnë realisht, janë të disponueshme dhe ndodhen në vendin e deklaruar**, duke shmangur mundësinë që mjetet të deklarohen vetëm formalisht për përmbushjen e kërkesave të tenderit, ndërkohë që në praktikë nuk janë në dispozicion për realizimin e kontratës.

E drejta për verifikim pa lajmërim paraprak justifikohet nga vetë qëllimi i kontrollit, pasi një njoftim paraprak mund të mos japë një pasqyrë reale mbi disponueshmërinë faktike të mjeteve në momentin e verifikimit. **Kjo e drejtë nuk përbën një kontroll arbitrar**, por është një mekanizëm verifikimi i lidhur drejtpërdrejt me kërkesën për disponueshmërinë e mjeteve dhe me detyrimin e operatorit ekonomik për të realizuar kontratën sipas kushteve të përcaktuara.

Gjithashtu, deklarimi i adresës së saktë të vendndodhjes së mjeteve i mundëson AK-së të kryejë verifikimin në mënyrë **objektive, transparente dhe të dokumentueshme**, duke garantuar trajtim të barabartë dhe kontroll të njëjtë për operatorët ekonomikë.

2.3.8 Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar, si dhe të përfshirë në listepagesa për periudhën muajin e fundit nga data e hapjes së ofertave, me profesionet si më poshtë:

- Teknik Ndërtimi	1 (nje)	Diplomë të shkollës mesme
- Teknik Hidroteknik	1 (një)	Diplomë të shkollës mesme
- Karpentierë	1 (nje)	Çertifikatë trajnimi/Dëshmi Profesionale
- Betonues	3 (tre)	Çertifikatë trajnimi/Dëshmi Profesionale
- Hekurkthyes	2 (dy)	Çertifikatë trajnimi/Dëshmi Profesionale
- Hidroizolues	1 (një)	Çertifikatë trajnimi/Dëshmi Profesionale
- Bojaxhi	1 (një)	Çertifikatë trajnimi/Dëshmi Profesionale
- Suvatues	2 (një)	Çertifikatë trajnimi/Dëshmi Profesionale
- Hidraulik	2(dy)	Çertifikatë trajnimi/Dëshmi Profesionale
- Elektracist	1 (dy)	Çertifikatë trajnimi/Dëshmi Profesionale
- Saldator	2 (dy)	Çertifikatë trajnimi/Dëshmi Profesionale
- Punëtorë asfalti	2 (dy)	Çertifikatë trajnimi/Dëshmi Profesionale

- Punëtorë të thjeshtë 3 (tre)

Argumentimi: Garantimi i Kapacitetit Teknik dhe Profesional (Neni 76 i LPP): Kërkimi i stafit të kualifikuar mbështetet drejtpërdrejt në të drejtën e Autoritetit Kontraktor për të vendosur kritere pranueshmërie që vërtetojnë se Operatori Ekonomik ka kapacitetet e nevojshme njerëzore për zbatimin e kontratës në përputhje me specifikimet teknike.

Garantimi i Cilësisë dhe Sigurisë në Punë (Neni 3 i LPP): Kërkesa për çertifikata trajnimi ose dëshmi profesionale për profesione me risk të lartë (si saldator, hidraulik, elektrikist, hekurkthyes, etj.) siguron që punimet do të kryhen në përputhje me normat ligjore të mbrojtjes në punë dhe standardet teknike në fuqi.

Verifikimi i Ekzistencës Reale të Stafit (Listëpagesa e muajit të fundit): Kërkesa e listëpagesës për muajin e fundit nga data e hapjes së ofertave përbën mjetin zyrtar provues për të verifikuar se punonjësit janë realisht të punësuar dhe të deklaruar pranë organeve tatimore, duke shmangur deklaratimet fiktive apo përfitimin e kontratave nga operatorë pa strukturë reale.

Stafi Drejtues/Mbikëqyrës (Teknik Ndërtimi & Teknik Hidroteknik Ndarja në dy teknike të mesëm është e nevojshme pasi punimet e ndërtimit dhe ato hidroteknike kërkojnë specifike të ndryshme ndjekjeje dhe zbatimi në kantier.

Stafi Specialist i Kualifikuar (Saldator, Elektrikist, Hidraulik, Hidroizolues - Këto procese kërkojnë njohuri specifike të çertifikuara për të garantuar mospraninë e defekteve kritike (p.sh. rrjedhje uji, lidhje të gabuara elektrike apo dëmtime izoluese) që do të cenonin qëndrueshmërinë e objektit.

Stafi i Punëve të Rënda e Strukturore (Hekurkthyes, Karpentier, Betonues, Punëtorë Asfalti -: Ekipi i punëve të struktura-ndërtimit mbulon proceset bazë të betonimit, armimit dhe shtrimit, ku numri i kërkuar i punonjësve korrespondon me rendimentin minimal të nevojshëm për realizimin e volumeve të punimeve brenda afatit kohor të kontratës.

2.3.9 Operatori Ekonomik duhet të disponojë dhe paraqesë çertifikatat të vlefshme si me poshte:

- Certifikatën e cilësisë së punimeve SSH/DIN/EN/UNI **ISO 9001-2015** e përditësuar, e vlefshme/ose/ekuivalent. Certifikata të jetë leshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- Certifikatën për Sistemin e menaxhimit të mjedisit SSH/DIN/EN/UNI **ISO 14001-2015**, (SSH/DIN/EN/UNI **ISO 14001-2026**) e përditësuar, e vlefshme /ose/ ekuivalent. Certifikata të jetë leshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- Certifikatën SSH/DIN/EN/UNI **ISO 45001:2018** e përditësuar, (SSH/DIN/EN/UNI **ISO 45001 – 2023**) e vlefshme/ ose ekuivalent (Mbi Sistemet e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë të punëtorëve në punë ose ekuivalent). Certifikata të jetë leshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

- SSH/DIN/EN/UNI ISO 39001:2012 e vlefshme/ ose ekuivalent (Sistem i menaxhimit te sigurisë rrugore dhe trafikut) ose **ekuivalent** Certifikata te jetë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi: Kërkesat e cilësisë të përcaktuara janë vendosur në mbështetje të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i publikuar, Neni 79, pika 1 ku citohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe në zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.

ISO 9001:2015 (Sistem i Menaxhimit të Cilësisë) është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit të cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërmarrjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërmarrje duhet t’i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërmarrjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky certifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

Në ndërtimin e rrugëve, ku cilësia e shtresave (bazë, nënbazë, asfalt) është kritike për jetëgjatësinë e investimit, ISO 9001 minimizon rrezikun e defekteve dhe punimeve jashtë standardit.

ISO 14001-2015, (SSH/DIN/EN/UNI ISO 14001-2026) (Sistem i Menaxhimit Mjedisor) ofron një kuadër praktik për shoqëritë që duan të menaxhojnë rreziqet **mjedisore** ekzistuese dhe potenciale. Ky sistem integrohet lehtësisht në strukturën e menaxhimit të biznesit për të kontrolluar impaktet që aktivitetet, operacionet, produktet dhe shërbimet kanë mbi mjedisin. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO **14001-2026** me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të identifikojë impaktin në mjedis gjatë aktivitetit të saj si dhe të përmirësojë performancën mjedisore duke zbatuar një qasje sistematike. Pra ky certifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ushtrojnë veprimtarinë duke pasur në konsideratë parimin e mbrojtjes së mjedisit.

ISO 45001:2018 /45001-2023, (Sistem i Menaxhimi i sigurisë dhe Shëndetit në punë) është standard ndërkombëtar, i cili parashtron kërkesat për menaxhimin e praktikave të mira të sigurisë dhe shëndetit në punë për çdo organizatë, pavarësisht nga madhësia. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 45001-2018 /45001-2023, me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci extra që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbytje me sukses të kontratës së punës objekt prokurimi. Punimet e ndërtimit të rrugëve përfshijnë rreziqe të larta (makineri të rënda, trafik, punë në terren). Kjo certifikatë siguron që: të identifikohen dhe menaxhohen rreziqet në kantier, mbrohen punonjësit dhe palët e treta, reduktohen aksidentet dhe incidentet në punë.

Kjo kërkesë është në përputhje me **nenin 79 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”**, pasi lidhet drejtpërdrejt me objektin e kontratës, është proporcionale me natyrën e punimeve dhe nuk kufizon kërkesa

për paraqitjen e certifikatës **SSH/DIN/EN/UNI ISO 39001:2012, të vlefshme ose ekuivalente**, është përcaktuar duke pasur parasysh natyrën dhe specifikat e objektit të prokurimit, i cili kërkon përdorimin e mjeteve rrugore dhe realizimin e transportit të materialeve, pajisjeve dhe personelit gjatë zbatimit të kontratës.

Standardi **ISO 39001** lidhet drejtpërdrejt me sistemin e menaxhimit të sigurisë së trafikut rrugor dhe synon që operatori ekonomik të ketë një qasje të strukturuar për **identifikimin dhe menaxhimin e risqeve që lidhen me lëvizjen e mjeteve në rrugë**, duke përfshirë drejtuesit e mjeteve, mjetet, transportin dhe mënyrën e organizimit të aktiviteteve që zhvillohen në rrjetin rrugor.

Kërkesa është vendosur për të garantuar që operatori ekonomik, gjatë realizimit të kontratës, të ketë një **sistem të dokumentuar të menaxhimit të sigurisë rrugore**, veçanërisht duke marrë në konsideratë lëvizjen e shpeshtë të mjeteve të transportit dhe makinerive që mund të përdoren gjatë punimeve.

Kjo certifikatë nuk kërkohet si një kriter formal apo i shkëputur nga objekti i kontratës, por lidhet me **kapacitetin teknik dhe organizativ të operatorit ekonomik për të menaxhuar në mënyrë të sigurt aktivitetet e transportit dhe përdorimit të mjeteve**, duke reduktuar risqet për punonjësit, përdoruesit e rrugës dhe palët e treta.

Te gjitha certifikata e mesiperme duhet të jene të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Nese ofertuesi do të paraqitet si bashkim operatorësh, certifikatat duhet të jene në përputhje me punimet e marra persiper.

2.3.10Operatori ekonomik per **Tuba HDPE SN8** duhet të paraqese:

1. Autorizim të prodhuesit/ve/distributor/ve për listën e mesiperme të mallrave. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit/distributorit si: telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij. (Në rastet kur autorizimi është në gjuhë të huaj duhet të bëhet përkthimi në gjuhën shqipe dhe noterizimi i tij.)

Në rast paraqitje autorizim distributori duhet të paraqitet kontrata e angazhimit midis prodhuesit dhe distributorit . (të përkthyer në shqip dhe të noterizuar).

2. Katalogun/et ose fragmente të katalogut/eve të prodhuesit/ve për listën e mesiperme, në të cilat të tregohen dhe të specifikohen qartë materialet që do të ofrohen në gjuhën shqipe ose angleze.

Operatori ekonomik per **Puseta Polipropileni** duhet të paraqese:

1. Autorizim të prodhuesit/ve/distributor/ve për listën e mesiperme të mallrave. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit/distributorit si: telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij. (Në rastet kur autorizimi është në gjuhë të huaj duhet të bëhet përkthimi në gjuhën shqipe dhe noterizimi i tij.)

Në rast paraqitje autorizim distributori duhet të paraqitet kontrata e angazhimit midis prodhuesit dhe distributorit . (të përkthyer në shqip dhe të noterizuar).

2. Katalogun/et ose fragmente të katalogut/eve të prodhuesit/ve për listën e mesiperme, në të cilat të tregohen dhe të specifikohen qartë materialet që do të ofrohen në gjuhën shqipe ose angleze.

Argumentimi: Pajisjet dhe materialet e kërkuara në specifikimet teknike janë përcaktuar në përputhje me projektin e zbatimit të objektit dhe preventivin e hartuar nga projektuesi i licencuar. Karakteristikat teknike të tyre janë nxjerrë nga llogaritjet hidraulike, mekanike dhe teknologjike të impiantit, duke marrë në konsideratë kapacitetin projektues, parametrat e funksionimit dhe kërkesat për trajtimin e ujërave.

Për këtë arsye, pajisje janë kërkuar me parametrat minimalë teknike të përcaktuar në projekt, pasi ato garantojnë funksionimin normal, të sigurt dhe efikas të impiantit. Parametrat e specifikuar nuk synojnë kufizimin e konkurrencës, por përcaktojnë kërkesat minimale funksionale që duhet të plotësojnë pajisjet, duke lejuar ofertimin e çdo produkti ekuivalent që plotëson ose tejkalon këto karakteristika.

Në përputhje me **nenin 36 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”**, specifikimet teknike janë hartuar mbi bazën e nevojave funksionale të autoritetit kontraktor dhe të projektit të miratuar, duke siguruar trajtim të barabartë për operatorët ekonomikë dhe duke mos krijuar pengesa të pajustifikuara për konkurrencën. Si dhe te garantoje jetegjatesine e tyre pra garancine ne rast defekti

2.3.11 Operatori ekonomik duhet te kete kontrate me nje laborator testimi te betonit, i cili duhet te jete i akredituar nga organizma kombetar ose nderkombetar sipas standarteve SSH EN 12390-3:2019 ose ekuivalente , SSH EN 12504-4:2021 ose ekuivalente, SSH EN 12350-2:2019 ose ekuivalente dhe SSH EN 12504-2:2021 ose ekuivalente

Argumentimi : Rrjetet e kanalizimeve janë vepra nëntokësore që ekspozohen ndaj presioneve të dherave, lëvizjeve të tokës dhe agjentëve agresivë kimikë (ujërat e zeza). Katër standardet e listuara mbrojnë projektin nga dështimi strukturor:

- **SSH EN 12350-2 (Testi i rënies / Slump-test):** Ky test mat konsistencën dhe punueshmërinë e betonit kur është i freskët. Nëse betoni ka më shumë ujë seç duhet, ai bëhet poroz. Poroziteti lejon depërtimin e ujërave të zeza, gjë që shkatërron strukturën e betonit nga brenda.
- **SSH EN 12390-3 (Rezistenca në shtypje):** Ky është testi kyç që garanton që pusetat, dhomat e kontrollit apo kunetat e betonit do të përballojnë peshën e dherave dhe trafikun e automjeteve sipër tyre pa u thyer e pa u shtypur.
- **SSH EN 12504-2 dhe 12504-4 (Testet jo-shkatërruese - Sklerometri dhe Ultratingujt):** Këto standarde lejojnë kontrollin e betonit direkt në kantier pasi ai është derdhur dhe ngurtësuar. Kjo bën të mundur verifikimin nëse kompania ka hedhur vërtet beton të cilësisë së lartë në çdo segment të kanalizimit.

2. Argumenti Ligjor (Përputhshmëria me Ligjin e Prokurimit)

- **Lidhja me objektin:** Sipas Ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", çdo kriter i vendosur duhet t'i përgjigjet natyrës dhe përmasave të kontratës. Meqenëse ndërtimi i kanalizimeve kërkon volume të mëdha punimesh betoni (pusetat, strukturat shkarkuese, nënshtresat), sigurimi i një laboratorit testues është një kapacitet teknik i domosdoshëm për realizimin e kontratës.

Te paraqitet kontrata noteriale si dhe dokumenti i akreditimit se bashku me standartin perkates

I. ARGUMENTIMI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Specifikimet teknike janë hartuar duke marrë në konsideratë nevojat e Autoritetit Kontraktor, për punët objekt procedure prokurimi, duke përllogaritur sasitë e nevojshme, karakteristikat e duhura dhe standardet e duhura kombëtare dhe ndërkombëtare, sipas parashikimeve të nenit 36, të Ligjit nr. 162, date 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Specifikimet teknike, janë hartuar në përputhje me legjislacionin përkatës për ndërtimet civile dhe infrastrukture dhe kanë për qëllim të sigurojnë cilësi të qëndrueshme, funksionalitet afatgjatë dhe siguri teknike të punimeve të parashikuara në rikonstruksionin e rrugëve në njësitë administrative. Për shkak të veçorive të terrenit dhe kushteve klimatike të zonës, janë përfshirë elementë të detajuar. Këto specifikime janë proporcionale me objektin e kontratës, të zbatueshme në praktikë dhe janë hartuar me kujdes për të

parandaluar keqzbatimin teknik, për të garantuar jetëgjatësinë e rrugës dhe për të krijuar kushte të sigurt qarkullimi për banorët e zonës.

Sipas specifikimeve bashkëngjitur të hartuar, vendosur dhe përlogaritur nga struktura të posaçme të specializuara, e konkretisht nga: “Grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike dhe përlogaritjen e fondit limit”, mbështetur në Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Ne perputhje me nenin 74 te VKM nr 285 date 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

”për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, pika 4, kriteret teknike u hartuan nga specialisti i fushës. Specifikime teknike, preventivi, afati dhe kriteret kualifikuese u pasqyruan në dokumentet e tenderit, bashkëlidhur.